



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Planned / Pre-dato Received / Delivery	23-02	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org / Unit	SKOMSHCK	800/2021	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.36/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.36/2021 të datës 28.01.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Fshati "Bardh i Madh", Nr.16, Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit/Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.36/2021 e datës 28.01.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 28.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 339/2021 të regjistruar me numër A.nr.36/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se organi i punësimit, respektivisht Komisioni për Miniera dhe Minerale nuk ka zbatuar legjislacionin aplikueshëm lidhur me ri zgjatjen e mandatit, nuk ka krijuar kushte për shpalljen e pozitës së lirë të Kryeinspektorit të Ministrave pran KPMM-së, si dhe te njëjtë pas përfundimit të mandatit i është mohuar e drejta që fillimisht te sistemohet në pozitë të kategorisë së mesëm drejtuese sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 01.02.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit te Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Këshilli më datë 05.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 339/2021 të regjistruar me numër A.nr.36/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 09.12.2020 nga ankuesi për U.d Kryesuesin e Bordit të KPMM-së; Njoftim e datës 08.12.2020 për ofrimin e pozitës së lirë në kuadër të KPMM-së, për ankuesin; Përgjigjen e datës 14.12.2020 nga ankuesi për Kryesuesin e Departamentit të Administratës së KPMM-së; Përgjigjen e datës 09.12.2020 nga Kryesuesi i Departamentit të Administratës, për ankuesin; E-mailin e datës 28.01.2021 nga ankuesi për KPMSHCK; Vendimin e datës 01.12.2015; Njoftimin për përzgjedhje të kandidatit nga raporti i KVK-së i datës 16.11.2015; Raportin e datës 09.11.2015 të Komisionit për Vlerësimin e Kriteve; Organogrami i KPMM-së si dhe njoftimi për pozitat e lira në vitin 2020 dhe 2021; Listen e pagave të muajit janar, prill, korrik, dhe tetor 2020; Njoftimin e datës 28.08.2020 lidhur me pozitat e kategorisë së lartë drejtuese dhe Përgjigjen në ankesë të datës 05.02.2021 nga KPMM.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se ankuesi përmes Vendimit me Nr.prot 59 të Kryesuesit të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me datë 01.12.2015 është emëruar në pozitën e Kryeinspektorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me mandat pesë (5) vjeçar. Emërimi i ankuesit në pozitën e Kryeinspektorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë sipas dispozitave të nenit 59 dhe 62 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, nenit 42 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, si dhe nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi me datë 30.11.2020 ka përfunduar mandatin 5 vjeçar si Kryeinspektor i KPMM-se. Pas përfundimit të mandatit të Kryeinspektorit, U.d Kryesuesi i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, përmes shkresës të datës 08.12.2020, ka njoftuar ankuesin se me datë 05.08.2020 ka përfunduar mandati i katër anëtarëve të KPMM-së, dhe si rezultat i kësaj ka qenë e pamundur vendimmarrja për vazhdimin e mandatit, me ç'rast në mungesë të pozitave të lira të nivelit të mesëm drejtues, ankuesit i ka ofruar mundësin e emërimit në pozitë të nivelit profesional, si Zyrtar i Teknologjisë Informative për Përkrahje në kuadër të Departamentit për Teknologji Informative.

Më datë 09.12.2020 ankuesi ka parashtruar kërkesë të U.d Kryesuesi i Bordit të KPMM-se, që të analizohet legjislacioni për procedurën e rekrutimit të pozitës së Kryeinspektorit të KPMM-se, sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa me datë 14.12.2020 ankuesi i është drejtuar Kryesuesit të Administratës të KPMM-se, duke njoftuar se pozita e ofruar e nivelit profesional nuk i përshtatet, dhe i njëjti ka kërkuar që të shqyrtohet mundësia e sistemimit në pozite të nivelit të mesëm drejtues dhe vetëm nëse nuk ka pozita të nivelit të mesëm drejtues të shqyrtohet mundësia e emërimit në nivelin më të lartë të kategorisë profesionale. Lidhur me

kërkesën e ankuesit, Kryesuesi i Administratës të KPMM-se, me datë 21.12.2020 ka njoftuar ankuesin se në kuadër të KPMM-se nuk ka pozita të lira të nivelit të mesëm drejtues, ndërsa pozitë e lirë e nivelit profesional është vetëm pozita e Zyrtarit të Teknologjisë Informative, dhe po ashtu ka njoftuar ankuesin se meqenëse nuk po e pranoni pozitën e Zyrtarit të Teknologjisë Informative, do ta përcjellin njoftimin të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publik pran Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mënyrë që të veprojnë në pajtim me kompetencat e përcaktuara ligjore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit, respektivisht Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk ka përfillur procedurat ligjore lidhur me ri zgjatjen e mandatit, dhe nuk ka krijuar kushte për shpalljen e pozitës së lirë të Kryeinspektorit të Minierave pran KPMM-së, dhe se te njëjtë pas përfundimit të mandatit i është mohuar e drejta që fillimisht të sistemohet në pozitë të kategorisë së mesëm drejtuese sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për ri zgjatje të mandatit ka analizuar dispozitat e nenit 83 paragrafi 8 ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se një nëpunësi civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke ushtruar mandatin e parë, mund ti ri zgjatet mandati, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje. Mirëpo duke u bazuar në nenin 42 paragrafit 1 pika 1 të Ligjit Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, ku përcaktohet se: *Me Inspektoratin e Minierave udhëheqë Kryeinspektori i cili zgjidhët nga Bordi i KPMM-së në përputhje me Ligjin në fuqi për shërbimin civil*, dhe duke marr parasysh shkresat e lëndës ku konstatohet se Bordi i KPMM-se, nuk është funksional nga data 05.08.2020, Kolegji vlerëson se KPMM, nuk ka mundur të bëjë rekomandimin dhe as të vendos për vazhdimin e mandatit të ankuesit në mungesë të kuorumit sepse kuorumi për mbledhjet e Bordit të KPMM-së është tre (3) anëtarë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 62 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit për vazhdim të mandatit dhe shpallje të konkursit është i pa bazuar.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në bazë të njoftimit të datës 08.12.2020 dhe njoftimit të datës 24.12.2021 ankuesit i ka ofruar pozitën e Zyrtarit të Teknologjisë Informative për Përkrahje në kuadër të Departamentit për Teknologji Informative, mirëpo meqenëse Njësisë Përgjegjëse nuk ka nxjerr një vendim në lidhje me këtë çështje, dhe duke marr parasysh se çështja e emërimit të ankuesit në një pozitë brenda shërbimit ende është në proces, Kolegji nuk u lëshua në trajtimin e mëtutjeshëm të këtij pretendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.36/2021

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

